38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t’i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t’i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t’i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhësimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41**Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**Neni 42****Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES**KUSHTET E VEÇANTA**

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Përkufizimet	1.3	Sipas kushteve të përgjithshme.
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: Gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% të vlerës së kontratës , për kohëzgjatjen e periudhës prej: [36 muaj + 30 ditë] , nga data e nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë e tyre, Impianteve dhe Materialeve gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, sëbashku me materialin dhe impiantin gjer në kosoton e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është: 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar; (d) Ndëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar, (ii) të personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar,
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 5 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të Projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë nga dita e caktuar në planin e menaxhimit nga menaxheri i projektit.

	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Dinamikës së punëve dhe arsyeshmeris së vonesave të lejuara nga organi mbykqyrës. Kontrata është: 36 muaj.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25 % e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është: 10 % e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në Vend – Punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi dhe testimi behet konform kushteve te përgjithshme te kontratës. Menaxheri i Projektit caktohet me vendim nga Z.K.A.
Pagesat	24.1	Pagesat do të bëhen në Euro. Autoriteti Kontraktues do ti paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacion.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: Nuk aplikohet.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% të vlerës së kontratës (me sigurim ekzekutimi).
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësi mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve do të jetë: 24 muaj. Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të punëve.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Zyra e Prokurimit – Komuna e Rahovecit ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin në Kosovë.


NDËRTIMI I PARQEVE REKREATIVE NE : RATKOC, DABIDOL, SENOC, POTAQAN I POSHTËM, SOPNIQ, CELINË, ZOOISHTË DHE RADOSTË					
PARKU RATKOC 1713 m²					
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1	PUNËT PËRGATITORE				
1.1	Inqizimi I parcelles ne vendin e parapare per ndertimin e parkut, si dhe bartja e pikave nga projekti ne terren se bashku me organin mbikqyres.	m²	1713.0	0.05 €	85.65
1.2	Pastrimi I parcelles nga mbeturinat e mundshme, materiali largohet ne deponi legale.	paush.	1.0	5.00 €	5.00
1.3	Kontrollimi dhe evdntimi i instalimeve nëntoksore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesit të ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e furnizimit të objekteve institucionale të prekura nga ndërtimi më të gjitha shërbimet publike: ujë sanitar, rrymë elektrike, largim të ujrave fekale si dhe më telefoni. Për të gjitha këto shërbime, kontraktori duhet të ofroj plan detal të furnizimit të përkohshëm të objekteve dhe për të gjitha hargjimet mban përgjegjesin kontraktuse, dmth. investitori nuk merr mbi vete kosto shtesë përveq çmimit që kontraktori oferton në kete pozicion, investitori ka të drejtën e ndërmarrjes së hapave që te furnizoi vet institucionet publike dhe lokalet afariste përmes kontraktimit të një kontraktori tjetër, përmes një kontrate emergjente (një person tjetër juridik) dhe tërë koston do ta mbaj kontraktori i ketij pozicioni.	paush.	1.0	10.00 €	10.00
GJITHSEJ POZICIONI 1 :					100.65
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
2	PUNËT E GËRMIMIT				
2.1	Gërmimi i dheut të kategoris III me trashësi t=20cm për pregatitjen e bazes së parkut. Transporti deri në deponi, apo deri ne vendin ku e cakton organi mbikqyres, largesi max deri 5km	m³	340.0	0.60 €	204.00
2.2	Nivelizimi, ngjeshja (kompaktimi) i nënbazës me cilindër vibrues me peshë 12t.	m²	1713.0	0.10 €	171.30
GJITHSEJ POZICIONI 2 :					375.30
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
3	MBUSHJA (PJESA E SIPËRME E PARKUT)				
3.1	Furnizimi ,transporti, vendosja e shtresës stabilizuese me gurënatyror (koherent) Mbushja te realizohet në gjithë hapësirën e sipërfaqes se parkut. Me t=40cm ne gjendje te ngjeshur.(ngjeshja me cilindër vibrues me peshe 12t)	m³	680.0	1.00 €	680.00
3.2	Furnizimi,transporti,vendosja dhe ngjeshja e shtresës stabilizuese me material guror që i plotëson kushtet e parapara për tampon.Mbushja te realizohet ne hapësirat e ku behet vendosja e gurve natyral. Fraksion 0-63mm, me trashësi t=20cm ne gjendje te ngjeshur.	m³	340.0	1.00 €	340.00
3.3	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës së tamponit me material guror. Mbushja te realizohet ne hapësirat e ku behet vendosja e gurve natyral. Fraksion 0-31.5mm, me trashësi t=10cm, në gjendje të ngjeshur, Ms=700kg/cm²	m³	171.3	7.00 €	1,199.10
3.4	Furnizimi, transporti, dhe vendosja gureve natyral te gdhendur me trashesi t=5-7cm , vendosja te behet mbi bazen e llacit te cimentos Mbushja te realizohet ne hapësirat e paraqitur ne projekt. Ne cmim te llogaritet edhe materiali cimentos.	m²	327.3	40.00 €	13,092.00
3.5	Furnizimi ,transporti dhe vendosja e gjeotekstilit 300 gr/m2 ne pjesen bankines dhe këndit per femije.	m²	214.2	1.00 €	214.20
3.6	Furnizimi, transporti, vendosja e shtresës së zhavorit. Fraksion 031.5mm, me trashësi t=10cm,ne pjesen e bankinave tkëndit per femije. Mbushja te realizohet ne hapësirat e paraqitur ne projekt.	m³	24.3	7.00 €	170.10



3.7	Furnizimi me material dhe punimi i dyshemesë nga goma fleksibile tek kendi i lojrave per femijë, "B40 rubber" t= 40 mm 500 x500 mm 28 kg, e recikluar me qëndrueshmëri UV, shtresa e sipërme me granula me EPDM, sipas standarte të BE standarti (EN1177: 2008), TÜV qertifikata. Shtresës nga betoni i armuar me trashësi 10cm me armaturë rrjetë Q-355, betonit ti shtohet aditivi për rezistencë ndaj lageshtisë. Ti kushtohet kujdes nivelimit dhe evitimit të gropave dhe deformimeve gjatë betonimit. Të gjitha shtresat e dyshemesë të jenë sistem i një prodhuesi duke përfshirë edhe ngjitësat adekuat. Ky pozicion të realizohet medeomos nga stafi profesional i trajnuar për realizim të produktit dhe në tërësi sipas udhëzimeve të prodhuesit.. Të ofrohet garancioni 3 vite . Obligim i punëkryesit është sigurimi i materialit dhe prodhimit gjatë realizimit dhe mbrojtja nga ndikimet atmosferike (të reshurat, dielli etj.). Punëkryesi gjatë ofertimit të prezantojë katalogun e materialit - prodhuesit dhe metodologjinë e realizimit. Pozicioni llogaritet me çmim njësi. Vërejtje: Pjerrtësia e terenit duhet të jetë 2-3%. Prodhuesi CSO Rubber Floorings ose prodhues i ngjajshëm me te njëjtat karakteristika.	m²	32.0	60.00 €	1,920.00
3.8	Gërmimi i dheut I kategoris III me trashësi t=40cm për zgjerimin e trasese se rrugës. Transporti deri në deponi, apo deri ne vendin ku e cakton organi mbikqyres, largesi max deri 5km	m³	147.4	0.60 €	88.44
3.9	Furnizimi,transporti,vendosja dhe ngjeshja e shtresës stabilizuese me material guror që i plotëson kushtet e parapara për tampon. Fraksion 0-63mm, me trashësi t=20cm ne gjendje te ngjeshur. Mbushja te realizohet ne hapësirat ku do te ndertohet rruga.	m³	78.2	1.00 €	78.20
3.10	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës së tamponit. material guror, fraksion 0-31.5mm, me trashësi T=10cm, në gjendje të ngjeshur, Ms=650kg/cm². Mbushja te realizohet ne hapësirat ku do te ndertohet rruga.	m³	39.1	7.00 €	273.70
3.11	Furnizimi, transporti dhe vendosja e kubzave të cilat realizohen ne hapësirat ku do te ndertohet rruga. Me dimensione 20x20x6 cm me ngjyre te hirit dhe te kuqe , ne qmim te kalkulohet shtresa e reres fraksion 4 mm me trashësi t=6 cm dhe mbushja e fugave te kubzave me rer te imet. Llogarija ne meter katrore.	m²	370	8.00 €	2,960.00
3.12	Furnizimi dhe montimi I skajoreve 8x20x80 cm ne qmim te kalkulohet edhe betoni per shtangim nen skajor dhe mes fugave.	m'	134.5	6.50 €	874.25
GJITHSEJ POZICIONI 3 :					21,889.99



NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
4	PUNET E ELEMENTEVE MIRKOURBANE				
4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulësës WOODY me mbështetëse nga prodhuesi me origjinë nga EU. Ulësja punohet prej paneleve të drurit masiv (lloji i drurit tropikal) të fiksuara me bulona prej çelikut të pakorodueshëm /inox-i (6 copë), duke krijuar një sistem sendviç i cili mban peshën e ulësës të mbështetur në këmbë prej çeliku të galvanizuar. Mbështetësja punohet prej një dërrase të vetme druri/paneli masiv të lidhur për traun prej çeliku te ngjyrosur me ngjyre te plastifikuar te zeze . Modeli i ulësës është LWD 150t me dimesione 2000x780x594mm. Ulësja kërkon mirëmbajtje minimale , pa shtresa përfundimtare me dru vetëm të impregnuar kundër dëmtimeve (insekte) për të ruajtur ngjyrën natyrore të drurit. Të gjitha punët duhet të përfundohen në pajtim me organi mbikqyrës. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU-së. Sipas detalit D-01 dhe D-01/a	cope	6	120.00 €	720.00
4.2	Furnizimi dhe punimi i tavolinave nga betoni parapregaditur me figuren e shahut ne sipërfaqe .Çdo tavolin ka nga dy karriga nga betoni i parapregaditur me mbështetje te mveshuara me drure.	cope	2	200.00 €	400.00
4.3	Furnizimi ,transporti dhe montimi i shportave per mbeturina ne form harkore me material nga druri pjese e brendshme te punohet nga llamarina.	cope	10.0	50.00 €	500.00
4.4	Furnizimi ,transporti dhe montimi i dyshemes nen uleseve rrethore me trashesi 2.4cm. Dyshemeja duhet te punohet nga materiali i druri i Kedrit (i cili paraprakishte eshte ushqyer me preparate mbrojtese nga insektet dhe ndikimet e jashme atmosferike)	m²	27.0	10.00 €	270.00
4.5	Furnizimi ,transporti dhe montimi i uleseve rrethore me mbeshtetje te punuara nga betoni i armuar i klasit C30/37 i papershkrueshem nga uji, dhe mbesht me mveshje finale nga druri i Kedrit (i cili paraprakishte eshte ushqyer me preparate mbrojtese nga insektet dhe ndikimet e jashme atmosferike)sipas detalit D4 .Dimensionet e ulseve 180x50x45 cm me Hmin=75 cm	cope	3.0	85.00 €	255.00
GJITHSEJ POZICIONI 4 :					2,145.00
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
5	PAISJET PER LODRAT DHE MATERIALET DEKORATIVE				
5	Paisjet per lodra ne hapësire te hapur.Paisjet te jene te prodhuara fabrikisht nga prodhuesi i specializuar ne kete lloj te prodhimit meprodukte te kualitetit te larte me siguri te posaqme te shfrytezimit te produktit , me funksionalizim, dizajn atraktiv dhe rezistence te madhe ndaj vandalizmit dhe kushteve atmosferike.Te gjitha paisjet te jene te punuara sipas standardeve ISO 14001 dhe ISO 9001 . Produkti te mos permbaje kemikalje te demshme . Çdo paisje te permbaje udhezimin e perdorimit dhe pershkrimin e funksioneve . Konstruksioni baze i produkteve te jete nga çeliku, te mbrojtura me ngjyre ekologjike me sistem puder ose zallim, te gjitha ne ngjyre orange.Çmimi perfshin furnizimin , transportin dhe montimin ne teresi sipas udhezimit te prodhuesit. Ofertuesi te prezantoje katalogje te prodhuesit te specializuar. ,Ngjyra në dy shtresa anti korriduese, ngjyra e gjelber sipas specifikimeve ne projekt, skelet, si dhe aksesoret				
5.1	Furnizimi me material si dhe montimi i paisjes për lodra me shtytje në drejtim poshtë lart dy ulse të vendosura në një shtyllë për fëmijë e dedikuar për moshën deri 12 vjet (Angl. Push Up Bars). Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jet funksional përfshirë punimin e themeleve nga betoni i armuar si dhe te gjitha ankerimet - ne teresi sipas udhezimit te prodhuesit.	cope	1	200.00 €	200.00
5.2	Furnizimi me material si dhe montimi i varseve për lodra të vendosura në një shtyllë për nje person e dedikuar për moshën deri 12 vjet. Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jet funksional.	cope	2	250.00 €	500.00
5.3	Furnizimi dhe montimi i luhajes aksiale me dy ulse te kapura me zingjir per femijë.	cope	1	350.00 €	350.00
5.4	Furnizimi me material si dhe montimi i rreshqiteses për femije të . Pozicioni përfshinë edhe të gjitha materialet dhe punët e nevojshme që ky aktivitet të jet funksional	cope	1	350.00 €	350.00
5.5	Furnizimi,transporti dhe montimi i hidrantit të jashtëm mbitokësor per uijtjen e barit me gype HDPE-RC tip 2 Ø90mm PN 16 bar. Në çmim të llogaritet kyqja ne rrejtin kryesor te ujsjellsit dhe të gjitha pjesët fazonike të hidrantit.			00 €	150.00



GJITHSE POZICIONI 5:

1,550.00



NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH	
6						
6.1	Furnizimi,transporti, shtrimi, rrafshimi dhe perpunimi dheut me trashesi (=10cm i klasit I per mbjelljen e barit, Dheu duhet te jete i permirsueshem qe lavrohet me mjete adekuate, te jete per bar natyral per parqe. Te krijohet pjerrtesia 1% per largimin e ujrave atmosferik	m³	124	0.80 €	99.20	
6.2	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drurit dekorativ- Panja (Acer platanoides "Globosum") , me kurorë mirë të formuar, 200 cm i lartë mbi sipërfaqen e dheut, perimetër të trungut 18-22 cm,sistem rrënjor mirë i zhvilluar, i përcjellur me dhe, dhe i çertifikuar. Mbillet në tetor-nëntor duke e hapur një grop me dimensione 70x70x70 cm, e e cila mbushet me dhe natyral (marr nga shtresa e sipërme e tokës, 0-25 cm thellësi, i cili ka teksturë lymore, lymore-argjilore ose ranore-argjilore, i pasur me materie ushqyese dhe pH nga dobët acidike deri dobët bazike, përkatësisht 6,1 deri 7,8), i cili paraprakisht përzihet me 1-1,5 kg treset (dhe i luleve) dhe 100-150 g pleh mineral i kombinuar NPK. Bimët nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues.	cope	25	15.00 €	375.00	
6.3	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e OPATIJA - përzieje e barit për sipërfaqet me diell, i çertifikuar. Mbillet në mars-prill ose gusht-shtator në thellësi 0,5 deri 1 cm dhe distancë 2-3 cm. Sasia e nevojshme për 1 m2 është 20-25 g. Pas mbjelljes bëhet ngjeshja me cilindra 30-50 kg të rëndë dhe ujitja me kujdes të shtuar. Toka në të cilën mbillet duhet paraprakisht të lavrohet në thellësi 20-25 cm, imtësohet dhe rrafshohet mirë, të jetë e pasur me materie ushqyese, tekstore të mirë dhe pH neutrale (dobët acidike deri dobët bazike), e të cilës duhet shtuar edhe 2 -5 kg/m2 treset dhe 15-20 g/m2 pleh mineral i kombinuar NPK. Në rast se toka ku mbillet nuk është e përshtatshme duhet të silllet dhe që i përmbush këto karakteristika në shtresë 15-20 cm. Bimët nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues. <i>Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres.</i>	m²	954.3	2.50 €	2,385.75	
GJITHSEJ POZICIONI 6:					2,859.95	
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH	
7	PUNËT E NDRIQIMIT					
7.1	Mihja e kanalit per shtrirje e kablos me dim: 80x40cm.	m	320	0.60	192.00	
7.2	Shtrirja e reres t=10+10cm.	m3	22.4	1.00	22.40	
7.3	Furnizimi dhe punimi i bazamenteve prej betoni 60x60x80cm.	copë	30	15.00	450.00	
7.4	Vendosja e shirit per paralajmrim "rrëzik për jetë".	m	320	0.1	32.00	
7.5	Furnizimi dhe montimi i kabllove energjetike NAYY-J 5x4mm².	m	350	1.00	350.00	
7.6	Furnizimi dhe montimi i kabllove energjetike NYY-J 3x1.5mm².	m	300	0.60	180.00	
7.7	Furnizimi i trupit ndricues LED 60W. Karakteristikat teknike: Total power: 60 W luminous flux*: 7800 lm Luminaire efficacy*: 130 lm/W Dimensions: 560x870x350 mm Weight: 8 kg Protection IP65LED Span >50,000Hrs(Ta=30°C@L70) Body Colour Gri Silver Operating Temperature -30°C to +50°C PFC >0.90 Protection Class Class I	Total IP Life	cope	30	65.00	1,950.00



7.8	Furnizimi dhe montimi i shtylles metalike e galvanizuar h=4m me lire l=0.3m ne forme te harkut me elementet percjellse si bulonat lidheshet dadot etj. Karakteristika teknike: Gjatësia 4m, a)2000 mm b)3000 mm c)850 mm ØQ1_114 mm ØQ2_76 mm -Pesha e shtylles m=58kg. -Dimensioni pllakes se shtylles 60x60x80cm per ankerim. -Ankerat Ø20mm. -Shtyllat duhet te ken a-test, nga prodhuesi.	copë	30	85.00	2,550.00
7.9	Furnizimi dhe montimi i tabelës se ndricimit te jashtem KSHE, me dimensione 800x400x20mm, IP65, propozohet CDCP,ABB, apo te ngjashme. Tabela duhet te jete metalike e galvanizuar, siq eshte pershkruar ne pershkrim teknike. Elementet përbërse janë: 1.Nderperës magneto termik AS-160/R63A, 3p, Icc=10kA. 2. Njehsor matës i energjisë 3f, 63A, per matje dirkete MAKEL. 3. Siguresa automatike 3p, C, 16A , Icc=6kA=4set. 4. Konkator 3p, 230V, 20A modulare =3cope. 5. Nderperes (0,1,2), 2p, 16A=3cope. 6. Fotoqeli 200lux=1pcs. 7. Siguresa automatike 6A,1p, C, Icc=6kA. 8. Materiali i imet lidhes.	copë	1	80.00	80.00
8	Furnizimi dhe montimi i shiritit të zinkuar FeZn 20x3 mm.	m	320	1.00	320.00
8.1	Furnizimi dhe montimi, i gyp i brinjëzuar PVC Ø 63mm.	m	320	0.90	288.00
8.2	Furnizimi dhe montimi, i grupit të siguresave nga poliesteri(aralgjite) per furnizimin e trupit ndricues 60W, LED: Karakteristikat teknike: 1.Tensioni nominal 450V. 2.Rryma nomina e sigureses 16A. 3.Numri i siguresës 2. 4.Tipi i kablllos kyqese 16/Al. 5. Temperatura e punes -50° deri 130°.	copë	30	1.00	30.00
8.3	Punimi i eleboratit per matjen e tokezimit mbrojtese, te cdo shtylle metalike.	copë	30	1.00	30.00
8.4	Material i imët lidhës i pa specifikuar.	Paushall	1	20.00	20.00
				GJITSHEJ POZICIONI 7:	6,494.40
				TOTAL :	35,415.29
PARKU DABIDOL 240 m²					
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1	PUNËT PËRGATITORE				
1.1	Inqizimi i parcelles ne vendin e parapare per ndertimin e parkut dhe parkingut , si dhe bartja e pikave nga projekti ne terren se bashku me organin mbikqyres.	m²	240.0	0.10 €	24.00
1.2	Pastrimi i parcelles nga mbeturinat e mundshme, materiali largohet ne deponi legale.	paush.	1.0	50.00 €	50.00
1.3	Kontrollimi dhe evdntimi i instalimeve nëntoksore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesit të ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e furnizimit të objekteve institucionale të prekura nga ndërtimi më të gjitha shërbimet publike: ujë sanitar, rrymë elektrike, largim të ujrave fekale si dhe më telefoni. Për të gjitha këto shërbime, kontaktori duhet të ofroj plan detal të furnizimit të përkohshëm të objekteve dhe për të gjitha hargjimet mban përgjegjesin kontraktuse, dmth. investitori nuk merr mbi vete kosto shtesë përveq çmimit që kontraktori oferton në kete pozicion, investitori ka të drejtën e ndërmarrjes së hapave që te furnizoi vet institucionet publike dhe lokalet afariste përmes kontraktimit të një kontraktori tjetër, përmes një kontratë emergjente (një person tjetër juridik) dhe tërë koston do ta mbaj kontraktori i ketij pozicioni.	paush.	1.0	50.00 €	50.00



	GJITHSEJ POZICIONI 1:	124.00



NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
2	PUNËT E GËRMIMIT				
2.1	Gërmimi i dheut të kategoris III me trashësi t=20cm për përgatitjen e bazës. Transporti deri në deponi, apo deri në vendin ku e cakton organi mbikqyres, largesi max deri 5km	m³	48.0	0.60 €	28.80
2.2	Nivelizimi, ngjeshja (kompaktimi) i nënbazës me cilindër vibrues me peshë 12t.	m²	240.0	0.30 €	72.00
	GJITHSEJTI				100.80
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
3	MBUSHJA (PJESA E SIPËRME E PARKUT)				
3.1	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës stabilizuese me material guror që i plotëson kushtet e parapara për tampon. Fraksion 0-63mm, me trashësi t=20cm në gjendje të ngjeshur.	m³	48.0	3.00 €	144.00
3.2	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës së tamponit me material guror. Fraksion 0-31.5mm, me trashësi t=10cm, në gjendje të ngjeshur, Ms=700kg/cm²	m³	24.0	7.00 €	168.00
3.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e kubzave. Me dimensione 20x20x6 cm me ngjyre të hirit dhe të kuqe, në qmim të kalkulohet shtresa e reres fraksion 4 mm me trashësi t=6 cm dhe mbushja e fugave të kubzave me rer të imet. Llogarija në meter katror.	m²	223.0	7.50 €	1,672.50
3.4	Furnizimi dhe montimi i skajoreve 8x20x80 cm në qmim të kalkulohet edhe betoni për shtangim në skajor dhe mes fugave.	m'	62.1	5.50 €	341.55
3.5	Furnizimi, transporti dhe betonimi i murit nga B.A h=2.2m x 0.25 m me shput të themelit 0.5x0.8 m. Me beton të armuar C25/30. Në cmim të llogaritet hapja dhe mbushja me zhavor nën themel dhe pjesën asnore të murit. Vërejtje Në cmim të llogaritet edhe pjesa e armimit	m'	22.4	55.00 €	1,232.00
3.6	Furnizimi, transporti dhe betonimi i shkalleve nga B.A. Me gjersi 2m. Me beton të armuar C25/30. Në cmim të llogaritet hapja dhe mbushja me zhavor nën shkallë. Vërejtje Në cmim të llogaritet edhe pjesa e armimit	m³	5.8	55.00 €	319.00
3.7	Furnizimi, transporti dhe mveshja e shkalleve dhe pjesë se sipërme të murit me granit artificial jo rreshqites. Në cmim të kalkulohe edhe materiali adekuat ngjites.	m²	37.6	20.00 €	752.00
	GJITHSEJTI POZICIONI 3:				4,629.05
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
4	PUNËT E ELEMENTEVE MIRKOURBANE				
4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulësës WOODY me mbështetëse nga prodhuesi me origjinë nga EU. Ulësja punohet prej paneleve të drurit masiv (lloji i drurit tropikal) të fiksuara me bulona prej çelikut të pakorodueshëm /inox-i (6 copë), duke krijuar një sistem sendviç i cili mban peshën e ulësës të mbështetur në këmbë prej çeliku të galvanizuar. Mbështetësja punohet prej një dërrase të vetme druri/paneli masiv të lidhur për traun prej çeliku të ngjyrosur me ngjyre të plastifikuar të zeze. Modeli i ulësës është LWD 150t me dimensione 2000x780x594mm. Ulësja kërkon mirëmbajtje minimale, pa shtresa përfundimtare me dru vetëm të impregnuar kundër dëmtimeve (insekte) për të ruajtur ngjyrën natyrore të drurit. Të gjitha punët duhet të përfundohen në pajtim me organi mbikqyrës. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU-së. Sipas detalit D-01 dhe D-01/a	cope	5	120.00 €	600.00
4.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i shportave për mbeturina në form harkore me material nga druri pjesa e brendshme të punohet nga llamarinat.	cope	10.0	55.00 €	550.00
4.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i hidrantit të jashtëm mbitorësor për ujitje të barit me gyp HDPE-RC tip 2 Ø90mm PN 16 bar. Në cmim të llogaritet kyqja në rrejtin kryesor të ujsjellsit dhe të gjitha pjesët fazonike të hidrantit.	cope	1	50.00 €	50.00
	GJITHSEJTI POZICIONI 4:				1,200.00



NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH	
5	PUNËT E GJELBRIMIT					
5.1	Furnizimi, transporti, shtrimi, rrafshimi dhe perpunimi dheut me trashësi t=10cm i klasit I per mbjelljen e barit, Dheu duhet te jete i permirsueshem qe lavrohet me mjete adekuate, te jete per bar natyral per parqe. Te krijohet pjerrtësia 1% per largimin e ujrave atmosferik	m³	124	0.50 €	62.00	
5.2	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drurit dekorativ- Panja (Acer platanoides "Globosum") , me kurorë mirë të formuar, 200 cm i lartë mbi sipërfaqen e dheut, perimetër të trungut 18-22 cm, sistem rrënjor mirë i zhvilluar, i përcjellur me dhe, dhe i çertifikuar. Mbillet në tetor-nëntor duke e hapur një grop me dimensione 70x70x70 cm, e e cila mbushet me dhe natyral (marr nga shtresa e sipërme e tokës, 0-25 cm thellësi, i cili ka teksturë lymore, lymore-argjilore ose ranore-argjilore, i pasur me materie ushqyese dhe pH nga dobët acidike deri dobët bazike, përkatësisht 6,1 deri 7,8), i cili paraprakisht përzihet me 1-1,5 kg treset (dhe i luleve) dhe 100-150 g pleh mineral i kombinuar NPK. Bimët nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues.	cope	16	15.00 €	240.00	
5.3	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e OPATIJA - përzieje e barit për sipërfaqet me diell, i çertifikuar. Mbillet në mars-prill ose gusht-shtator në thellësi 0,5 deri 1 cm dhe distancë 2-3 cm. Sasia e nevojshme për 1 m2 është 20-25 g. Pas mbjelljes bëhet ngjeshja me cilindra 30-50 kg të rëndë dhe ujitja me kujdes të shtuar. Toka në të cilën mbillet duhet paraprakisht të lavrohet në thellësi 20-25 cm, imtësohet dhe rrafshohet mirë, të jetë e pasur me materie ushqyese, teksture të mirë dhe pH neutrale (dobët acidike deri dobët bazike), e të cilës duhet shtuar edhe 2 -5 kg/m2 treset dhe 15-20 g/m2 pleh mineral i kombinuar NPK. Në rast se toka ku mbillet nuk është e përshtatshme duhet të silltet dhe që i përmush këto karakteristika në shtresë 15-20 cm. Bimët nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues. <i>Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyres.</i>	m²	954.3	2.50 €	2,385.75	
GJITHSE POZICIONI 5:					2,687.75	
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH	
6	PUNËT E NDRIQIMIT					
6.1	Mihja e kanalit per shtrirje e kablos me dim: 80x40cm.	m	95	0.60	57.00	
6.2	Shtrirja e reres t=10+10cm.	m3	6.4	1.00	6.40	
6.3	Furnizimi dhe punimi i bazamenteve prej betoni 60x60x80cm.	copë	15	15.00	225.00	
6.4	Vendosja e shirit per paralajmrim "rrëzik për jetë".	m	95	0.1	9.50	
6.5	Furnizimi dhe montimi i kabllave energjetike NAYY-J 5x4mm².	m	110	1.00	110.00	
6.6	Furnizimi dhe montimi i kabllave energjetike NYY-J 3x1.5mm².	m	100	0.60	60.00	
6.7	Furnizimi i trupit ndricues LED 60W. Karakteristikat teknike: Total power: 60 W luminous flux*: 7800 lm Luminaire efficacy*: 130 lm/W Dimensions: 560x870x350 mm Weight: 8 kg Protection IP65LED Span >50,000Hrs(Ta=30°C@L70) Body Colour Gri Silver Operating Temperature -30°C to +50°C PFC >0.90 Protection Class Class I	Total IP Life	cope	15	65.00	975.00



6.8	Furnizimi dhe montimi i shtylles metalike e galvanizuar h=4m me lire l=0.3m ne forme te harkut me elementet percjellse si bulonat lidheset dadot etj. Karakteristika teknike: Gjatësia 4m, a)2000 mm b)3000 mm c)850 mm ØQ1_114 mm ØQ2_76 mm -Pesha e shtylles m=58kg. -Dimensioni pllakes se shtylles 60x60x80cm per ankerim. -Ankerat Ø20mm. -Shtyllat duhet te ken a-test, nga prodhuesi.	copë	15	85.00	1,275.00
6.9	Furnizimi dhe montimi i tabelës së ndricimit të jashtëm KSHE, me dimensione 800x400x20mm, IP65, propozohet CDCP,ABB, apo të ngjashme. Tabela duhet të jetë metalike e galvanizuar, siq është përshkruar në përshkrim teknik. Elementet përbërse janë: 1.Nderperës magneto termik AS-160/R63A, 3p, Icc=10kA. 2. Njehsor matës i energjisë 3f, 63A, për matje direkte MAKEL. 3. Siguresa automatike 3p, C, 16A , Icc=6kA=4set. 4. Konkator 3p, 230V, 20A modulare =3cope. 5. Nderperes (0,1,2), 2p, 16A=3cope. 6. Fotoqeli 200lux=1pcs. 7. Siguresa automatike 6A,1p, C, Icc=6kA. 8. Materiali i imet lidhes.	copë	1	80.00	80.00
7	Furnizimi dhe montimi i shiritit të zinkuar FeZn 20x3 mm.	m	95	1.00	95.00
7.1	Furnizimi dhe montimi, i gyp i brinjëzuar PVC Ø 63mm.	m	95	0.90	85.50
7.2	Furnizimi dhe montimi, i grupit të siguresave nga poliesteri(aralgjite) për furnizimin e trupit ndricues 60W, LED: Karakteristikat teknike: 1.Tensioni nominal 450V. 2.Rryma nomina e sigureses 16A. 3.Numri i siguresës 2. 4.Tipi i kabllos kyqese 16/Al. 5. Temperatura e punës -50° deri 130°.	copë	15	1.00	15.00
7.3	Punimi i eleboratit për matjen e tokezimit mbrojtëse, të çdo shtylle metalike.	copë	15	1.00	15.00
7.4	Material i imët lidhës i pa specifikuar.	Paushall	1	10.00	10.00
GJITHSEJ POZICIONI 7 :					3,018.40
TOTAL :					11,760.00



PARKU SENOC 780 m ²					
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1	PUNËT PËRGATITORE				
1.1	Inqizimi I parcelles ne vendin e parapare per ndertimin e parkut , si dhe bartja e pikave nga projekti ne terren se bashku me organin mbikqyres.	m ²	780.0	0.10 €	78.00
1.2	Pastrimi I parcelles nga mbeturinat e mundshme, materiali largohet ne deponi legale.	paush.	1.0	50.00 €	50.00
1.3	Kontrollimi dhe evdntimi i instalimeve nëntoksore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi I planit detal operativ që lidhet me procesit të ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e furnizimit të objekteve institucionale të prekura nga ndërtimi më të gjitha shërbimet publike: ujë sanitar, rrymë elektrike, largim të ujrave fekale si dhe më telefoni. Për të gjitha këto shërbime, kontaktori duhet të ofroj plan detal të furnizimit të përkohshëm të objekteve dhe për të gjitha hargjimet mban përgjegjesin kontraktuse, dmth. investitori nuk merr mbi vete kosto shtesë përveq çmimit që kontraktori oferton në kete pozicion, investitori ka të drejtën e ndërmarrjes së hapave që te furnizoi vet institucionet publike dhe lokalet afariste përmes kontraktimit të një kontraktori tjetër, përmes një kontratë emergjente (një person tjetër juridik) dhe tërë koston do ta mbaj kontraktori i ketij pozicioni.	paush.	1.0	50.00 €	50.00
GJITHSEJ POZICIONI 1 :					178.00
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
2	PUNËT E GËRMIMIT				
2.1	Gërmimi i dheut të kategoris III me trashësi t=20cm për pregatitjen e bazës. Transporti deri në deponi, apo deri ne vendin ku e cakton organi mbikqyres, largesi max deri 5km	m ²	156.0	1.00 €	156.00
2.2	Nivelizimi, ngjeshja (kompaktimi) i nënbazës me cilindër vibrues me peshë 12t.	m ²	780.0	0.50 €	390.00
GJITHSEJ POZICIONI 2 :					546.00
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
3	MBUSHJA (PJESA E SIPËRME E PARKUT)				
3.1	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës stabilizuese me material guror që i plotëson kushtet e parapara për tampon. Fraksion 0-63mm, me trashësi t=20cm ne gjendje te ngjeshur.	m ³	156.0	2.00 €	312.00
3.2	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës së tamponit me material guror. Fraksion 0-31.5mm, me trashësi t=10cm, në gjendje të ngjeshur, Ms=700kg/cm ²	m ³	78.0	7.00 €	546.00
3.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e kubzave. Me dimensione 20x20x6 cm me ngjyre te hirit dhe te kuqe , ne qmim te kalkulohet shtresa e reres fraksion 4 mm me trashesi t=6 cm dhe mbushja e fugave te kubzave me rer te imet. Llogarija ne meter katrore.	m ²	780.0	7.50 €	5,850.00
3.4	Furnizimi dhe montimi I skajoreve 8x20x80 cm ne qmim te kalkulohet edhe betoni per shtangim nen skajor dhe mes fugave.	m'	137.3	6.00 €	823.80
GJITHSEJ POZICIONI 3 :					7,531.80



NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
4	PUNET E ELEMENTEVE MIRKOURBANE				
4.1	Furnizimi, transporti dhe montimi i shportave per mbeturina ne form harkore me material nga druri pjese e brendshme te punohet nga llamarina.	cope	10.0	50.00 €	500.00
4.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i ulësës WOODY me mbështetëse nga prodhuesi me origjinë nga EU. Ulësja punohet prej paneleve të drurit masiv (lloji i drurit tropikal) të fiksuar me bulona prej çelikut të pakorodueshëm /inox-i (6 cope), duke krijuar një sistem sendviç i cili mban peshën e ulësës të mbështetur në këmbë prej çeliku të galvanizuar. Mbështetësja punohet prej një dërrase të vetme druri/paneli masiv të lidhur për traun prej çeliku te ngjyrosur me ngjyre te plastifikuar te zeze . Modeli i ulësës është LWD 150t me dimeione 2000x780x594mm. Ulësja kërkon mirëmbajtje minimale , pa shtresa përfundimtare me dru vetëm të impregnuar kundër dëmtimeve (insekte) për të ruajtur ngjyrën natyrore të drurit. Të gjitha punët duhet të përfundohen në pajtim me organi mbikqyrës. Produkti duhet të jetë me origjinë nga vendet e EU-së. Sipas detalit D-01 dhe D-01/a	cope	6	120.00 €	720.00
GJITHSEJ POZICIONI 4 :					1,220.00
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
5	PUNËT E GJELBRIMIT				
5.1	Furnizimi, transporti, shtrimi, rrafshimi dhe perpunimi dheut me trashesi t=10cm i klasit I per mbjelljen e barit, Dheu duhet te jete i permirsueshem qe lavrohet me mjete adekuate, te jete per bar natyral per parqe. Te krijohet pjertësia 1% per largimin e ujrave atmosferik	m³	15	0.80 €	12.00
5.2	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drurit dekorativ- Panja (Acer platanoides "Globosum") , me kurorë mirë të formuar, 200 cm i lartë mbi sipërfaqen e dheut, perimetër të trungut 18-22 cm, sistem rrënjor mirë i zhvilluar, i përcjellur me dhe, dhe i çertifikuar. Mbillet në tetor-nëntor duke e hapur një grop me dimeione 70x70x70 cm, e e cila mbushet me dhe natyral (marr nga shtresa e sipërme e tokës, 0-25 cm thellësi, i cili ka teksturë lymore, lymore-argjilore ose ranore-argjilore, i pasur me materie ushqyese dhe pH nga dobët acidike deri dobët bazike, përkatësisht 6,1 deri 7,8), i cili paraprkasht përzihet me 1-1,5 kg treset (dhe i luleve) dhe 100-150 g pleh mineral i kombinuar NPK. Bimët nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues.	cope	20	15.00 €	300.00
5.3	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e OPATIJA - përzieje e barit për sipërfaqet me diell, i çertifikuar. Mbillet në mars-prill ose gusht-shtator në thellësi 0,5 deri 1 cm dhe distancë 2-3 cm. Sasia e nevojshme për 1 m2 është 20-25 g. Pas mbjelljes bëhet ngjeshja me cilindra 30-50 kg të rëndë dhe ujitja me kujdes të shtuar. Toka në të cilën mbillet duhet paraprkasht të lavrohet në thellësi 20-25 cm, imtësohet dhe rrafshohet mirë, të jetë e pasur me materie ushqyese, teksture të mirë dhe pH neutrale (dobët acidike deri dobët bazike), e të cilës duhet shtuar edhe 2 -5 kg/m2 treset dhe 15-20 g/m2 pleh mineral i kombinuar NPK. Në rast se toka ku mbillet nuk është e përshtatshme duhet të sillet dhe që i përmbush këto karakteristika në shtresë 15-20 cm. Bimët nuk guxojnë të jenë të infektuar me ndonjë sëmundje apo dëmtues. <i>Te gjitha punet duhet te kryhen ne pajtim me projektantin dhe ne udhezim te organit mbikqyrës.</i>	m²	150	2.50 €	375.00
GJITHSEJ POZICIONI 5 :					687.00
TOTAL :					10,162.80



PARKU POTAQAN I POSHTEM 4131 m ²					
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
1	PUNËT PËRGATITORE				
1.1	Inqizimi I parcelles ne vendin e parapare per ndertimin e parkut dhe parkingut , si dhe bartja e pikave nga projekti ne terren se bashku me	m ²	4131.0	0.05 €	206.55
1.2	Pastrimi I parcelles dhe demolimi I shkurreve nga mbeturinat e mundshme, materiali largohet ne deponi legale.	paush.	1.0	50.00 €	50.00
1.3	Kontrollimi dhe evdntimi i instalimeve nëntoksore, zgjidhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi I planit detal operativ që lidhet me procesit të ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e furnizimit të objekteve institucionale të prekura nga ndërtimi më të gjitha shërbimet publike: ujë sanitar, rrymë elektrike, largim të ujrave fekale si dhe më telefoni. Për të gjitha këto shërbime, kontaktori duhet të ofroj plan detal të furnizimit të përkohshëm të objekteve dhe për të gjitha hargjimet mban përgjegjesin kontraktuse, dmth. investitori nuk merr mbi vete kosto shtesë përveq çmimit që kontraktori oferton në kete pozicion, investitori ka të drejtën e ndërmarrjes së hapave që te furnizoi vet institucionet publike dhe lokalet afariste përmes kontraktimit të një kontraktori tjetër, përmes një kontratë emergjente (një person tjetër juridik) dhe tërë koston do ta mbaj kontraktori i ketij pozicioni.	paush.	1.0	50.00 €	50.00
GJITHSEJT POZICIONI 1 :					306.55
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
2	PUNËT E GËRMIMIT				
2.1	Gërmimi i dheut të kategoris III me trashësi t=20cm për pregatitjen e bazes së parkut. Transporti deri në deponi, apo deri ne vendin ku e cakton organi mbikqyres, largesi max deri 5km(gërmimi te realizohet ne hapsirat e trajtuara ne projekt)	m ³	98.0	0.60 €	58.80
2.2	Nivelizimi, ngjeshja (kompaktimi) i nënbazës me cilindër vibrues me peshë 12t.	m ²	480.0	0.30 €	144.00
GJITHSEJ POZICIONI 2 :					202.80
NR.	PËRSHKRIMI I POZICIONIT	Njësia	Sasia	Çmimi per njesi (€) ME TVSH	TOTALI ME TVSH
3	MBUSHJA (PJESA E SIPËRME E PARKUT)				
3.1	Furnizimi,transporti,vendosja dhe ngjeshja e shtresës stabilizuese me material guror që i plotëson kushtet e parapara për tampon.Mbushja te realizohet ne hapesirat e trajtuara ne projekt. Fraksion 0-63mm, me trashësi t=20cm ne gjendje te ngjeshur.	m ³	144.0	2.00 €	288.00
3.2	Furnizimi, transporti, vendosja dhe ngjeshja e shtresës së tamponit me material guror. Mbushja te realizohet ne hapesirat e e trajtuara ne projekt. Fraksion 0-31.5mm, me trashësi t=10cm, në gjendje të ngjeshur, Ms=700kg/cm ²	m ³	48.0	7.00 €	336.00
3.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e kubzave ne hapesirat e trajtuara ne projekt. Me dimensione 20x20x6 cm me ngjyre te hirit dhe te kuqe , ne qmim te kalkulohet shtresa e reres fraksion 4 mm me trashesi t=6 cm dhe mbushja e fugave te kubzave me rer te imet. Llogarija ne meter katrore.	m ²	284.0	7.50 €	2,130.00
3.4	Furnizimi dhe montimi I skajoreve 8x20x80 cm ne qmim te kalkulohet edhe betoni per shtangim nen skajor dhe mes fugave.	m'	310	6.00 €	1,860.00
3.5	Furnizimi ,transporti dhe vendosja e gjeotekstilit 300 gr/m2 ne pjesen e kendit per femije.	m ²	80.0	1.00 €	80.00
3.6	Furnizimi, transporti, vendosja e shtresës së zhavorit. Fraksion 031.5mm, me trashësi t=10cm,ne pjesen e kendit per femije. Mbushja te realizohet ne hapesirat e paraqitur ne projekt.	m ³	5.5	7.00 €	38.50



